

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

Lënda: LISTA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR QË DUHET DORËZUAR PËR KËRKESAT MIRATIM PROJEKT KËRKIMOR-SHKENCOR NË VAZHDIM, SISTEMATIK

Kjo listë ka vetëm vlerë orientuese, në çdo rast ASHA do të vlerësojë aplikimin dhe do të përcaktojë rast pas rasti në varësi të projektit që do të zhvillohet dhe zonën përkatëse, dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.

- 1. Kërkesë për miratim projekti kërkimor - shkencor** e firmosur nga përfaqësues i institucionit të specializuar IA/QSA, shoqëruar me dokumentacionin për çdo projekt të ri.
- 2. Për të gjithë bashkëpunimet me institucionet e huaja**, në rastet kur marrëveshjes së bashkëpunimit i ka përfunduar afati, të dorëzohet një kopje e marrëveshjes së rinovuar.
- 3. Kopje të vendimit për miratimin e projektit nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë.**
 - Plani i përgjithshëm me koordinatat në një nga sistemet e më poshtme koordinatave:
 - Albanian 1987, EPSG:4191
 - Albanian 1987 / Gauss-Kruger zone 4, EPSG: 2462
 - WGS 84, EPSG: 4326
 - WGS 84 / UTM zone 34N, EPSG: 32634
 - KRRGJSH 2010 (ETRS89 / Albania TM 2010), EPSG: 6870ku të jetë evidentuar me koordinata zona ku është kryer dhe ku parashikohen ndërhyrjet në vitin për të cilin kërkon miratim. Plani duhet të dorëzohet në një nga formatet vektoriale në të cilin është përpunuar, si **DWG, DXF, SHP**, etj. Në rastin kur projekti është hartuar në programe **GIS**, bashkë me **SHP** duhen dorëzuar dhe skedarët e projekteve (**MXD për ArcGIS apo QGS për Quantum GIS**).
 - Përshkrimi me të dhënat teknike të vendit ku parashikohet të kryhet operacioni, të sipërfaqes dhe thellësisë.
 - Përcaktimi i pritshmërisë shkencore për vitin kur aplikon (çfarë pritjet të zgjidhë projekti në fjalë).
 - Drejtuesi ose bashkëdrejtuesit shkencorë të projektit, si dhe lista e ekipit të angazhuar në projekt nëse ka ndryshime.
 - Informacion mbi institucionin/institucionet financuese të projektit.
 - Periudha kohore (muaji) kur do të realizohet projekti shkencor për vitin e aplikimit.
 - Në zbatim të VKM Nr.725, Datë 21.05.2008, Pika 13, çdo projekt dhe dokumentacioni që e shoqëron, duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose të noterizuara.
 - Përcaktimi i venddepozitimit të gjetjeve arkeologjike shoqëruar nga lista e gjetjeve. Një kopje e listës së gjetjeve dorëzohet pranë ASHA.
 - Relacioni i rezultateve të projektit kërkimor-shkencor për vitin paraardhës.

- **Prezantimi në *Power-Point*** i projektit, ku do të jenë të specifikuara qartë: gjurma në plan, foto të zonës, ndërhyrjet e mëparshme në këtë zonë (nëse ka pasur), gjendja aktuale dhe objektivat që synon projekti ose foto të objekteve që do të studiohen për mbledhjen e KKA.